



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:180965

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06789462

KF.nr.442/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “BE Konstruct” ShPK me numër unik identifikues 810121385, dhe me seli në fshatin Gushafc Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Kushtrim Kastrati, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 28,550.13€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat Kushtrim Kastrati, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 20.01.2025 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “BE Konstruct” ShPK me numër unik identifikues 810121385, dhe me seli në fshatin Gushafc Mitrovicë, sa i përket qarkullimit shtesë që ka rezultuar nga rritja e çmimeve të shitjes.
- II. ANULOHET pjesërisht vendimi nr.209/2021 i datës 13.07.2021 i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, sa i përket qarkullimit shtesë që ka rezultuar nga rritja e çmimeve të shitjes.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, “BE Konstruct” ShPK me numër unik identifikues 810121385, dhe me seli në fshatin Gushafc Mitrovicë t’ia pranoj shitjet e mallit për qëllime të TVSH-së ashtu siç janë deklaruar nga vet paditësi dhe ta shtoj balancën kreditore për TVSH në vlerë prej 27,059.14€, si dhe t’ia kthej paditësit shumën prej 1,874.91€ në emër tatimit shtesë në Tatimin në të Ardhura të Korporatave, së bashku me ndëshkimin dhe interesat e llogaritura mbi këtë shumë.

IV. REFUZOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit sa i përket trajtimit të kostos së mallit të shitur dhe paditësi mbetet obligues për pagesën e tatimit në të Ardhura të Korporatave në vlerë prej 19,570.28€.

V. MBETET NË FUQI vendimi kontestues sa i përket trajtimit të kostos së mallit të shitur.

VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 17.08.2021, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.209/2021 të datës 13.07.3.21, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës administrative, konstatimit ta gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi mbetet në tërësi pranë padisë si dhe provave të ofruara dhe deklarimeve të paraqitura në seancat e datës 25.06.2024 dhe 04.10.2024. Konfirmojmë pranimin e plotësimit të ekspertizës të datës 18.10.2024 të punuar nga ana e ekspertit financiar prof.dr Sh. B., e që konsiderojmë me plotësimin e ekspertizës është konstatuar gjendja faktike e njëjtë dhe e plotësuar tani ekspertizën bazë, ku e njëjta ka bërë përcaktimin e saktë të tatimit, ndëshkimeve për periudha dhe lloje të tatimeve ashtu siç është kërkuar në seancën e kaluar për të cilat është vërtetuar se ATK-ja në mënyrë të kundërligjshme ka ngarkuar paditësin me tatim shtesë, ndëshkime dhe interes ashtu siç është përcaktuar në faqen e gjashtë të plotësim ekspertizës. Po ashtu konfirmojmë edhe pranimin e parashtresës së të paditurës për kundërshtimin e plotësim ekspertizës, e që konsiderojmë se ky kundërshtim nuk ka përmbajtje konkrete lidhur me konstatimet ekspertizës financiare dhe plotësimit të saj, por përmban vetëm disa përshkrime abstrakte dhe jo konkrete e të cilave çështje që në mënyrë profesionale konsiderojmë se i ka dhënë përgjigje vet ekspertiza financiare. Po ashtu me qëllim të sqarimit të plotësimit të ekspertizës në këtë seancë vetëm për qëllime sqarimi do i parashtrijmë dy pyetje ekspertit financiar në lidhje me pyetjen 1 të plotësim ekspertizës në të cilën eksperti financiare ka konstatuar se vendimi i ATK-së ka qenë në pajtueshmëri me vendimin shpjegues publik 03/2016 dhe me ligjin 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar me qëllim që eksperti të sqaroj se kur e ka dhënë këtë konstatim a ka menduar të konstatonte se mendimi është bazuar në këtë bazë ligjore sepse nëse do mbetej ky konstatim konsiderojmë se pastaj do të ishte në kundërthënie me pjesën tjetër të ekspertizës dhe plotësimit të saj ku eksperti ka konstatuar se ATK ka pasur mjaftueshëm prova për të mos zbatuar metodat indirekte të vlerësimit siç ka ndodhur në vendimin e ATK-së. Po ashtu kërkojmë nga eksperti që në këtë seancë të jap një

elaborim të shkurtër të pjesës kur konstaton se pse e paditura nuk ka vepruar drejtë kur ka aplikuar metodat indirekte të vlerësimit. Dhe për fund pas marrjes të këtyre sqarimeve referuar edhe të theksuarve si më sipër në bazë të nenit 99 dhe nenit 257 par 2 të LPK-së, e rregullojmë petitumin e padisë dhe kërkojmë nga kjo gjykatë që të nxjerrë këtë aktgjykim: Aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit BE Konstrukt SHPK. Anulohet vendimi kontestues i të paditurës 209/2021 i datës 13.07.2021. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kthejë mjetet e paguara në emër të tatimit në korporata (CD) për periudhën tatimore 2019 në tatimin bazë në vlerë prej 18,945.19 euro, interes në vlerë prej 1,970.24 euro dhe ndëshkime në vlerë prej 7,634.70 euro ose në vlerë të tërësishme prej 28,550.13 euro, me kamatë sipas vendimit të Ministrisë së Financave nga data e pagesës së kështit të fundit me datë 04.02.2022 së kryerjes së obligimeve e deri në kthimin e tyre definitiv në llogarinë bankare si dhe shpenzimet procedurale për përfaqësim për këtë seancë në shumë prej 270.40 euro sipas tarifës së OAK-së në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 08.04.2022 deklaroi se vendimi kontestues është i bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor dhe e konteston padinë e paditësit si të pabazuar. Tutje deklaroi se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit të parashtruara në padi pasi që me rastin e kontrollit është konstatuar gjendja në bazë të nenit 13, 14 dhe 15 të Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010. Po ashtu e paditura konstaton se vendimi kontestues është mbështetur në nenin 19 paragrafi 8 i Ligjit nr.03/L-222 dhe nenit 25 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Për periudhën tatimore 2019, blerjet nga importi në vitin 2019 periudha e kohore e transaksionit të KMSH-së, është respektuar me kontroll Vendimi Shpjegues Publik nr.03/2016 për Vlerësimet dhe Rivlerësimet Doganore dt.02.06.2016. Gjithashtu sa i përket vlerësimit të shitjeve, kontrolli i ka trajtuar në vështrim të nenit 24 të Ligjit 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Andaj ATK-ja ka vepruar konform legjislacionit në fuqi kur e ka trajtuar ankesën e paditësit dhe ka nxjerr vendimin nr.209/2021 datë 13.07.2021. Tutje i propozon gjykatës që të refuzohet ankesa e paditësit si e pabazuar dhe të aprovohet vendimi i divizionit të ankesave të ATK-së nr.209/2021 datë 13.07.2021 si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në bazë të dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se, në seancë nuk ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur, mirëpo me

parashtrësën e datës 10.01.2025 e njëjta e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë dhe ka kërkuar të veprohet konform nenit 38 paragrafi 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 20.01.2025, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi nr. 209/2021 datë 13.07.2021, Raporti i kontrollit i datë 017.05.2021, Qarkullimi bankar, Formular i deklarimit TVSH periudha 03/2019 dhe libri i shitjes për këtë periudhë, Formulari i deklarimit të TVSH dhe libri i shitjes për periudhën 10/2019, Përgjigje në padi e datës 08.04.2022, Ankesë në DA datë 10.06.2021, Formularët i deklarimit TVSH dhe librat e shitjes për periudhat 02/2019, 05/2019, 12/2019, 05/2020, 06/2020, 07/2020, 08/2020, 11/2020, 12/2020, AU 001 dt 12.03.2021, Intervista fillestare DUD-at dhe faturat ( të bashkangjitura përgjigjes në padi), Vendimi shpjegues publik nr. 3/2016, Ekspertizë financiare e datës 02.08.2024, Plotësimi i ekspertizës i datës 22.10.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga Raporti i Kontrollit i dates 07.05.2021, shkresat e lëndës si dhe vendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se ATK, ka kryer kontroll për subjektin “BE-Konstrukt” ShPK me seli në Mitrovicë, këtu paditësin, për periudhat dhe llojet e tatimeve: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar TVSH për periudhën 01/2019 deri 12/2020, Tatim në të Ardhura e Korporatave (CD) për vitin 2019, Tatim të Mbajtur në Burim (ËM) dhe Kontributet Pensionale (CM) për periudhën 01/2019 deri 12/2020. Me ri kontroll paditësit i janë rritur të hyrat nga shitja dhe i është zvogëluar kostoja e mallit të shitur me c’rast ka rezultuar në zvogëllimin e balancës kreditore të TVSH-së në vlerë prej 27,059.14€ dhe tatim shtesë në të ardhurat e korporatave në vlerë prej 21,445.19€.

Më vendimin kontestues 209/2021 të datës 13.07.2021 paditësit i është refuzuar si e pabazë ankesa nr.209/2021 e datës 15.06.2021, ndërsa njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll janë vërtetuar si të pabazuara. Në arsyetimin e vendimit të kontestuar është konstatuar se

vlerësimi zyrtar nga ana e ATK-së është bërë mbështetur ne nenin 19 paragrafi 1, 2 dhe 8 të Ligjit nr.03/L-222, nenit 24 dhe nenit 25 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar si dhe Vendimi Shpjegues Publik nr.03/2016 për Vlerësimet dhe Rivlerësimet Doganore.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.442/22 të datës 26.06.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar-administrativ me ekspertin financiar Sh. B., me detyra përkatëse si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Eksperti financiar në mendimin dhe konstatimin e dhënë në ekspertizën financiare të datës 02.08.2024 dhe në plotësim ekspertizën e datës 22.10.2024 dhe gjate seancës së shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar se gjatë analizës së të gjithë DUD-ave vërehet se DUD-i me nr.26337 i datës 10.10.2019 dhe DUD-i R 1248 i datës 21.01.2020 çmimin e blerjes e kanë më të ulët se çmimi i shitjes, prandaj kontrolli ka konstatuar gabimisht gjendjen kur ka rritur çmimin e shtijës për këta dy DUD-a. Në tabelën nr.1 në plotësim ekspertizë, eksperti ka paraqitur vlerën totale të obligimeve doganore dhe ka konstatuar se shuma gjithsej e obligimeve që paditësi i ka paguar është 28,550.13.

Gjykata ka marr për bazë pjesërisht ekspertizën financiare pasi që e njëjta sa i përket pjesës së qarkullimit shtesë si rezultat i rritjes së çmimit ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, ndërsa sa i përket vlerësimit në lidhje me koston e mallit të shitur duke u mbështetur ne Vendimin shpjegues Publik nr.03/2016, gjykata konstaton se eksperti nuk ka paraqitur fakte reale në ekspertizë për ta ndryshuar gjendjen nga raporti i kontrollit.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës në lidhje me pikën I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar sa i përket qarkullimi dhe tatimit shtesë, që ka rezultuar nga rritja e çmimeve të shitjes, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në fakt, në vendimin e kontestuar por edhe në raportin

e kontrollit, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuar është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Gjykata vëren se e paditura në vendimin kontestues nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore të paditësit sa i përket rivlerësimeve të çmimit të shitjes për arsye se vendimin kontestues në lidhje me këtë pretendim është cekur vetëm kjo fjali: “*Gjithashtu sa i përket vlerësimit të shitjeve, kontrolli i ka trajtuar në vështrim të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH neni 24 që përcakton shumën e tatueshme për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve*”. Ky vlerësim në vendimin kontestues është kontradiktor me atë që është konstatuar në raport të kontrollit të datës 07.05.2021, për arsye se inspektorja tatimore bazën ligjore që e ka cekur vazhdimisht në raport të kontrollit në lidhje me këtë vlerësim ka qenë neni 25 paragrafi 1 i Ligjit 05/L-037.

Neni 25 paragrafi 1 i Ligjit 05/L-037 parasheh “*1.Shuma e tatueshme në lidhje me importimin e mallrave përcaktohet si vijon: 1.1. në lidhje me importimin e mallrave, shuma e tatueshme duhet të jetë vlera për qëllime doganore, e përcaktuar në pajtueshmëri me legjislacionin doganor të Kosovës në fuqi*”. Gjykata konstaton se kjo dispozitë ligjore zbatohet për të përcaktuar shumën e tatueshme që ka të bëjë me importin e mallrave, ndërsa në rastin konkret inspektori tatimor të njëjtën dispozitë ligjore e ka zbatuar në lidhje me vlerësimin e çmimeve të shitjes. Prandaj gjykata nuk mund ta pranojë vlerësimin e të paditurës të dhënë në vendimin kontestues se kontrolli rivlerësimin e shitjeve e ka bërë konform nenit 24 të Ligjit 05/L-037 për TVSH.

Gjykata ka shqyrtuar edhe bazën ligjore në lidhje me nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-037 e cila parasheh: *Neni 24 Shuma e tatueshme për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve 1. Shuma e tatueshme për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve përcaktohet si vijon: 1.1. në lidhje me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, ndryshe nga ajo që është referuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, shuma e tatueshme duhet të përfshijë çdo gjë që përbën konsideratën e marrë ose që do të merret nga furnizuesi, në kthim për furnizimin nga konsumatori apo pala e tretë, duke përfshirë këtu subvencionet e lidhura direkt me çmimin e furnizimit;*”, mirëpo gjykata konstaton se as mbi bazën e kësaj dispozite ligjore nuk mund të përcaktohet çmimi i shitjes ashtu siç ka vepruar inspektorja në Raportin e Kontrollit, për arsye se ashtu siç nuk pranohet si kosto e mallit shuma e rivlerësuar nga Dogana e Kosovës, njëjtë duhet të veprohet edhe sa i përket përcaktimit të çmimit të shitjes. Inspektorja tatimore në Raportin e kontrollit sa i përket vlerësimit të çmimeve të shitjes ka pranuar vlerën e rivlerësuar nga Dogana e Kosovës si vlerën blerëse të mallit, ndërsa nga ana tjetër sa i përket vlerësimit të koston së mallit të njëjtën vlerë nuk e ka pranuar si KMSH.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditurës dhe kundërshtimet e bëra ndaj ekspertizës financiare, mirëpo konsideron se të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për të ndryshuar gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata në këtë procedurë gjyqësore. Kjo për faktin se e paditura në vendimin kontestues ka përmendur një bazë tjetër ligjore nga ajo në të cilën është mbështetur inspektorja tatimore në raport të kontrollit. Prandaj në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, ballafaqimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të vendimit kontestues, gjykata vlerësoi se organi i paditur ATK-së ka nxjerr konkluzion jo të drejt në pikëpamje të gjendjes faktike edhe atë lidhur me trajtimi e paradhënieve si të ardhur të tatueshme, prandaj Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore sa i përket kësaj pike kontestuese.

Vlerësimet faktike dhe juridike sa i përket pikës IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket pjesë refuzues të kërkesëpadsisë së paditësit, gjykata vendosi pasi që nga provat e administruara dhe nga dispozitat ligjore në fuqi të legjislacionit tatimor, rezulton që vlerësimi tatimor i të paditurës për Tatim në të Ardhura Korporatave për vitin 2019, mbi të cilën bazë ka rezultuar me kontroll edhe tatimi shtesë për paditësin në shumë prej 19,570.28€ për Tatim në të Ardhura të Korpotatave, është i bazuar, kjo për faktin se deri te këto detyrime tatimore shtesë e paditura me kontroll ka ardhur në pajtim me vendimin Shpjegues Publik 03/2016 për Vlerësimet dhe Rivlerësimet Doganore. Në bazë të këtij vendimi gjykata konstaton se rivlerësimi i DUD-ave nga Dogana e Kosovës, për paditësit afekton në TVSH dhe Taksa Doganore, ndërsa nuk ka efekt në koston e mallit të shitur, për faktin se vlera e rivlerësuar nga dogana mund të pranohet si KMSH vetëm në rastet kur paditësi dëshmon se e ka paguar mallin ashtu siç është rivlerësuar. Në rastin konkret paditësi nuk ka paraqitur dëshmi se mallin e ka paguar sipas rivlerësimeve doganore prandaj nuk mund të pranohet si kosto një shumë e cila nuk është dëshmuar me pagesë. Ndërsa sa i përket shpenzimeve për pagesën e taksave doganore shtesë që kanë rezultuar nga rivlerësimi i mallit të njëjtat duhet të pranohen si shpenzime të zbritshme. Po ashtu edhe TVSH në import, në bazë të shpjegimeve nga vendimi shpjegues publik 03/2016 duhet llogaritet mbi shumën e rivlerësuar. Prandaj bazuar në shpjegimet e nxjerra nga ky vendim shpjegues publik gjykata konstaton se pretendimi i paditësit është i pabazuar.

Gjykata vlerën e këtij kontesti e ka nxjerr nga Raporti i Kontrollit në të cilën është konstatuar se zvogëlimi i balancës Kreditore për TVSH është 27,059.14€, ndësa tatimi në vlerë prej 1,874.91€ është nxjerr nga tabela në faqen 16 të raportit të Kontrollit ku në kolonën “Sipas Kontrollës” është ndryshuar vetëm vlera e të ardhurave bruto, ku të ardhurat bruto janë paraqitur ashtu siç janë deklaruar nga paditësi, dhe nga ky ndryshim ka rezultuar edhe diferenca në tatim në të ardhura të korporatave.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Mbi bazën e të lartshënuarave, e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.442/22 datë 20.01.2025

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.